REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:031173
Datë: 26.10.2018
Numri i dokumentit: 00156628

P.nr.84/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi, – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.B. nga Gjakova, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1647/2015, të datës 11.02.2016, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën **26.10.2018**, në prezencën e Prokurorit së shtetit Enis Gashi, të akuzuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **L.B.,** i biri i M., dhe i ëmës Z., e gjinisë L., i lindur me datën data e lindjes... në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën "L.D." nr...., ka të kryer fakultetin, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: Me datë 20.11.2015 në ora 19.50 në Gjakovë respektivisht në rrugën "L. D." në një lokal kishte takuar të dëmtuarin D.M. të cilin fillimisht e kishte fyer ndërsa më pastaj e kishte sulmuar fizikisht duke e goditur me grushta në fytyrë. duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjorë Dr. M.G. të dt. 12.01.2016

-me çka ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

DËNIM ME GJOBË:

2018:031174

Dënim me gjobë në shumë prej **300.-(Treqind**)Euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 (pesëmëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,oo.-Euro,** dhe në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor të paguaj shumën prej **20,00- euro,** e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi

I dëmtuari D.M. nga Gj. ku edhe tani banon në rr.”B.B.” lagja D., kompensimin e dëmit mund ta realizojë në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1647/2015, të datës 11.02.2016, kundër të akuzuarit L. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.1 të KPRK-së, Prokurori i shtetit Enis Gashi në shqyrtimin gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit L.B., andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Fillimisht Prokurori i shtetit ka ngritur Aktakuzë me PP.nr.1647/2015, të datës 11.02.2016 duke propozuar që ndaj të akuzuarit L.t B. ti nxjerrë urdhër ndëshkimor me të cilin të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë, Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorit dhe të njëjtin e ka shpallur përgjegjës dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 250 Euro, si dhe ka obliguar në kompensimin e shpenzimeve procedurale, me aktgjykimin me nr P.nr.84/16 të dt.15.11.2016,i akuzuari ka paraqitur kundërshtim kundër aktgjykimit- urdhër ndëshkimor të lartë cekur në afatin ligjor , prandaj Gjykata ka mbajte shqyrtimin gjyqësor ndaj të akuzuarit L. B., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.l të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor Prokurori i shtetit Enis Gashi pasi dëgjoi të dëmtuarin D. M. se si janë shkaktuar lëndimet trupore si dhe në bazë të akt ekspertimit mjeko-ligjor të lëshuar nga Dr.M. G., atëherë bëri përmisimin e dispozitivit të aktakuzës, ashtu që në rreshtin e katërt pas fjalisë e kishte sulmuar fizikisht e tani në vend të pjesëve të ndryshme të trupit duhet të qëndroi duke e goditur me grushta në fytyrë, ndërsa pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pa ndryshuar si dhe bëj përmisimin e kualifikimit juridik ashtu që pas paragrafit 1 duhet të shtohet nën par.1.4 të KPRK-së.

I akuzuari L.B. në shqyrtimin gjyqësor të dt.26.10.2018 lidhur me fajësinë deklaron se pranoi fajësinë ashtu siç qëndron në dispozitivin e aktakuzës të përmisuar nga ana e prokurorit, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare duke ditur më parë për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë.

Pasi Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se

2018:031174

janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par. 4, të KPPK-së, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Enis Gashi në fjalën përfundimtare deklaroi se, në këtë shqyrtim gjyqësor u vërtetua se veprimet faktike të akuzuarit siç janë përshkruar në dispozitiv të aktakuzës PP.nr.1647/15 të dt.11.02.2016, u argumentuan dhe u vërtetuar edhe nga vetë fakti i pranimit të fajësisë së të akuzuarit edhe gjithë kjo rezulton edhe me shkresat tjera në lëndë, dhe konsideroi se i akuzuari L.B.është përgjegjës për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-ës, dhe kërkoi që të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari D. M. në fjalën përfundimtare deklaron, se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit, sipas traditave tona babai i L. dhe vetë L. më kanë kërkuar falje për veprimet e bëra, të cilit ia kam falur gabimin, L. e kam në lagje dhe prej atij momenti me të njëjtin nuk kam pas asnjë mosmarrëveshje, tani jemi pajtuar në mesë veti, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë.

I akuzuari L.B. në fjalën e tij përfundimtare sërish bëri pranimin e fajësisë, deklaron se menjëherë pas rastit jam penduar pa masë prandaj edhe të dëmtuarit i kam kërkuar falje i cili edhe ma ka falur gabimin dhe tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti, jetojmë në të njëjtën lagje, shton se jam i pa punë, andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Me faktet e ofruara, me provat që bashkëngjiten në shkresat e lëndës, e sidomos me pranimin e fajësisë nga i akuzuari është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-ës, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marr parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e thellë të tij, sjelljet korrekte të akuzuarit në gjykim, gjendjen e tij ekonomike, është i pa punë, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, kërkim falje të dëmtuarit, si rrethanë rënduese Gjykata mur parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me veprimet e tij të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime trupore, rrethanat në të cilat është kryer vepra , motivet për kryerjen e veprës, të gjitha këto rrethanat ndikuan që Gjykata të njëjtit ti shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **300.- (Treqind**)Euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor dhe në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2, nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

2018:031174

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i përgjithshëm-
P. nr.84/16 më datë 26.10.2018.

Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.